

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

854-32

L. 28

**shpresa kamani**

tregim për heroin

**FRROK  
KAÇORRI**

814-32  
K28

S

SHPRESA KAMANI

TREGIM PER HEROIN  
FRROK KAÇORRI

39056



1382

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT POLITIK



**Errok Kaçorri**

## Në vend të parathënjes

Ne do të shkruanim për ty edhe pa këtë vdekje heroike, o Frrok Kaçorri. Ti i takoje asaj armate, që asnjëri tani më nuk mund ta injorojë. Ti i takoje klasës punëtore, që mbart mbi shpatullat e saj progresin e shtyn përpara rrotën e historisë. Ne do të shkruanim për ty, për forcën e madhe të shpirtit tënd, për ndërgjegjen tënde të kuqe, se kjo është era jote, o punëtor. Ty, punëtor, të takojnë edhe buzëqeshja e agimeve industriale, edhe vallëzimet e arta të grunjoreve.

Ne do të shkruajmë për thjeshtësinë tuaj, për heroizmin tuaj, se ne na duhen thjeshtësia juaj, vullnetet tuaja, heroizmi juaj, që t'i mbjellim anemban atdheut, që t'i bëjmë pronë e flamur, që t'i bëjmë mish e gjak të secilit. Thjeshtësia juaj, heroizmi juaj, nuk u takon me juve. Ato janë forca e gjithë klasës sonë, e gjithë popullit tonë. Ato janë farca e Partisë sonë.

Ne do të shkruajmë për ty, se vdekja jote në krye të detyrës e lartësoi edhe më shumë figurën tënde, figurën e ndritur të punëtorit tonë revolucionar.

Ne do të shkruajmë për ty, se jeta dhe vdekja

jote është gjuha që më bukur flet për Partinë tonë, për Partinë e Enver Hoxhës.

Ne do të shkruajmë për ty, se duke shkruar për ty ne shkruajmë faqet e ndritura të historisë sonë, të epokës së socializmit triumfues.

## Një lindje e bardhë, një vdekje e ndritur

Frrok Kolë Kaçorri erdhi në jetë bashkë me agimin e epokës së madhe, atëhere kur atdheu ende nuk i kishte hequr qafe bandat e diversantëve dhe i ati i Frrokut ndiqte pyjeve mbeturinat e reaksionit. U lind dhe u rrit ky djalë nën rapallitjet e botës së vjetër që po jepte shpirt. I mbushi ky djalë mushkëritë me ajrin e sapopastruar nga tymi e me erën e re të shëndetshme të truallit të lirë. U rrit me jehonën e luftës nadhnjimtare, me gjënimin e minave, që prinin industrializimin socialist të vendit. I ndjeu edhe ai pushkët e diversantëve, e pa edhe ai babën, partizanin që se kish hequr armën, të përlotur kur i vranë shokun; e pa motrën në rrugën e madhe të Partisë për ndërtimin e jetës së re në Shqipërinë e lirë. I pat folur Tata për grurin që mbinte në arë e për hasmin që priste në mes ëndrrat rinore. Dhe me sytë e tij ai pa se si u humbi kuptimi frengjive, e se si ju ndërrua rruga lumenjve. Pa si lindën liqenjtë e rinj e si nxuarën tym oxhaqet e minierës. Ai u ngjiti shpateve me gjeologët e u dha hov ëndrrave të para, kur sondat shtatlarta prekën thesaret virgjër.

Dhe të gjitha këto ai i pa nën një dritë. Nën dri-

tën e Partisë që paralajmëronte të nesërmen e ndritur. Prandaj ideal i jetës së tij u bë komunisti dhe ëndërr e jetës së tij u bë Partia. Prandaj ai s'shihte asnjë pengesë kur ishte fjala për të shpënë në vend porosinë e Partisë. Prandaj ai i bënte dy ditë bashkë e natën ditë. Prandaj ai nuk largohej kurrë nga fronti i punës pa plotësuar e pa tejkaluar planin. Ai nuk deshë të largohej as atë ditë. . . Oh! Ajo ditë! Ajo nuk qe e zakonit për Frrokun. Një ditë më parë shokët e tij minatorë, delegatë në Konferencën e 18-të të Partisë për rrethin e Rrëshenit, i prunë atij një lajm gazmor, një sihariq të madh.

— A ke zemër me qëndrue, o Frrok Kaçorri?

— Folë, he bre burrë, se zemra ma mirë i qëndron dhimes se sa gëzimit!

— Bash për gëzim due me të forcue, o Frrok Kaçorri! Je zgjedhë delegat në Kongresin e 6-të të Partisë, o Frrok.

Qeshën sytë e minatorit si asnjëherë. Rrahu zemra e tij më fuqishëm se kurrë. Ndoshta në ato dy ditë që pasuan atë lajm, ajo përballoi rrahjet e gjithë jetës.

— Do të shkosh në kongres, o Frrok.

— Do të çosh fjalën tonë, o minator.

— Do të takosh Enver Hoxhën. Falj me shëndet nga ne. Ne nuk të dërgojmë atje pa plan të realizuar. Do të vemë të gjithë forcën dhe muskujt tanë, ne nuk do t'i kursehemi.

Kështu thoshin minatorët, kështu thoshte Frroku.

Dhe Frroku mudohej që t'i kryente të gjitha detyrat mirë. Duhej të justifikonte besimin e madh. Një detyrë tjetër e madhe shoqërore e priste ato di-

të. Ai duhej të merrte pjesë në një stërvitje ushtarake. Në repartin e madh, Frroku ishte komandant i kompanisë së parë. Ai shkoi në pikën e hapjes. Bëri plan konspektin, mori të gjitha masat. Dy ditë më vonë, bashkë me shumë shokë, do të provonte veten edhe si luftëtar, edhe si drejtues ushtarak.

Ai do të ndahej për disa ditë nga marteli i tij. Edhe shokë të tjerë do të linin frontët e punës. Ata që do të mbeteshin do të punonin në mënyrë të sforcuar. Për më tepër në planin e mineralit kishte defekte. Ishte pikërisht kjo që e shqetësonte Frrokun. Kudo që të ishte, ai duhej të përgjigjej njësoj për planin, për mineralin. Prandaj, posa kishte mbaruar 8-orëshin dhe kishte kryer detyrën e tij, ai ju lut brigadierit armator Nikollë Frëng Lleshit.

— Si thue, o Nikollë, a nuk e shblokojmë furnelin105/1? — Nikolla ngurroi një sekondë pastaj u përgjigj: — Po jena të lodhun, o Frrok. E lemë për nesër.

— Nesër?! Po nesër kemi punë të tjera. Pas nesër unë do të iki. E di ç'do të thotë 15 ton mineral në turn? Haj, Nikollë, provojmë. Jemi para stërvitjes. T'u lemë front pune shokëve.

— 15 ton, the? Jo, or jo, 20, — tha Nikolla, të cilin Frroku i kishte ngacmuar sedrën e i kishte ndjellur gëzimin e fitores. — Provojmë, — vazhdoi ai. — Dhe të dy shokët ju përveshën punës. Puna e armatorit as që i takonte Frrokut. Po zëri i ndërgjegjes nuk pyet për rregulla e urdhëra. Ai është zëri i devotshmërisë së komunistit, që i jep krahë e vrull njeriut të punojë jashtë detyrave që i takojnë.

Në kohën kur Frroku po punonte në furnel u dëgjua zëri i një minatori:

— Frrok, eja se të kërkojnë! Ka ardhur Prenga, eja të mbushësh fletanketën e delegatit.

— I thoni se po vij, ja tani, posa të mbaroj punën që kam në dorë.

Po pak më vonë, erdhi lajmëtari tjetër, zëvendëssekretari i organizatës së Partisë.

— Të presin, o Frrok. Nxitohu. Duhet mbushur fletanketa.

Po Frroku nuk doli nga furneli as kur e thirri lajmëtari i tretë. Ai e përcolli pasi i tha Nikollës: «Është gëzim i madh të mbushësh fletanketën pasi të kesh shblokuar furnelin, pasi të kesh siguruar 20 ton mineral në turn.» Dhe në sfondin e hirtë, në fytyrën e tij që kishte marrë ngjyrën e mineralit, qeshën gëzueshëm sytë e tij.

E pastaj të dy këta minatorë të zotë filluan punën, në një furnel 18 m. të gjatë, në kushtet e rënda dhe të vështira të punës nëntokësore. E kur kishin arritur fundin, kur pjesa më e madhe e furnelit qe shblokuar, ndodhi gjëma, tragjedia. Dhe ja se, si: ra pak dhé, pak ujë. Këto kanë kuptim të madh për minatorin, janë shenja që thonë se galeria lëviz. Nikolla ishte poshtë, Frroku në mes të furnelës.

— A e ndjeve, Frrok?

— Po, Nikollë, — ju përgjegj Frroku. Dhe, pa mbaruar mirë fjalën, ra përsëri dhé e ujë. Ata nxituan. Por koha nuk priste. Frroku mezi arriti të thotë «Nxitou, Nikollë, ikë! Furneli po shembet.» U dëgjua një gjëmim i shurdhër, një rrapëllimë gurësh e minerali, dhe një trup u shemb përdhe e u ngjesh, nën peshën e rëndë.

Alarm! Rëndën minatorët për të shpëtuar shokët. E ç'tu them për zemrat e drithëruara të mina-



torëve, për katër orët plot ankth, me nerva të tendosura, me zemrën pesh? Atje, nën gurët, nën shkëmbin e errët ishin shokët që prisnin ndihmë. Rronin apo kishin mbaruar? Çfarë nuk do të jepnin ata veç të shtrëngonin edhe një herë dorën e Frrokut, Nikollës, t'u dëgjonin zërin, t'u ndjenin frymëmarrjen! Nikollën e gjetën me frymë. Një shkëmb i mprehtë i kishte hyrë në ballë. Trupi ishte mbytur në gjak, po frymë merrte. Asgjë nuk siguronte se mund të shpëtonte. Po ai as që mendonte për vete. Dikush tjetër kishte më shumë nevojë për ndihmë. «Frroku! Nxitoni te Frroku», tha ai me zë të mekur. Por ishte shumë vonë. Ballin e kishte të nxehtë ende po zemra nuk i rrihte më.

Dhe kjo ndodhi më 14 shtator 1971, në orën 17.30, dy ditë pas konferencës së 18-të të Partisë të rrethit të Rrëshenit, që e zgjodhi Frrokun delegat për në Kongresin e 6-të të PPSH dhe anëtar të plenumit. Ai, pra, nuk arriti ta mbushte fletanketën.

Fletanketën e tij e mbushën minatorët atje buzë tramozheve, atje në ballë të galerive, nëpërmjet bisedave të tyre të dhimbshme, po optimiste. Dhe kjo fletanketë është një portret plot ngjyra e dritë, plot patos revolucionar e hove të guximshme. Është portreti i komunistit, që për çeshtjen e socializmit, nuk di të kursejë as jetën.

## **Gjethi i njomë nuk mbin në degë të thatë**

Atje, në të dalë të Rrëshenit, në të djathtë të rrugës automobilistike që ngjitet drejt zemrës



I ati e ëma dhe gruaja me vajzën e Frrok Kaçorrit

së Mirditës, mbi një kodër ngrihet një shtëpizë e vogël. Kurrë ajo shtëpi nuk priti e nuk përcolli miq sa ato ditë, sa ditët që rodhën pas 14 shtatorit 1971. Kurrë ajo shtëpizë e vogël nuk e tregoi më fuqishëm zemrën e madhe të saj, zemrën e Frrokut e të Marës, të Kolës e të Davës.

Dhe sa më e vogël të duket shtëpia, aq më e madhe ngrihet para syve të tu bota e këtyre njerëzve të thjeshtë, e këtyre njerëzve pa pretendime. Duke parë këtë shtëpi, duke parë këta njerëz, e kupton më mirë madhësinë e Frrok Kaçorrit, jetën, punën dhe vdekjen e tij. Frrokun nuk mund ta kuptosh jashtë kësaj shtëpie. Kjo shtëpi është historia e pashkruar e fshatarit mirditor, që ndoqi rrugën e

Partisë e, njësh me të, eci në ballë për jetë me të mirë, pa gardhe e sinore, pa lot e mjerime, pa kanune e çelë. Njerëzit e kësaj shtëpie kanë mes dallgësh e furtunash, mes paragjykimesh e zakonesh dhe shpunë kudo fjalën e Partisë dhe ngjallën kudo entuziazmin e jetës së re.

Kurrë Kolë Kaçorrit, babës së Frrokut, nuk ja errësoi mendjen interesi i ngushtë. Duke luftuar për një jetë më të lumtur, ai ja nënshtroi këtë qëllim interesit të përgjithshëm. Ky interes, këto ideale e udhëhoqën atë në punën dhe luftën e tij. Edhe kur atdheu krahas pushkës vuri kazmën, krahas tankseve vuri traktorët për të ndërtuar jetën e re, Kolë Kaçorri nuk kërkoi një qoshe të ngrohtë e as e quajti të mbaruar luftën.

Kur Marta e Prena Tarazhi binin nga dora e kriminelëve gjakaçarë, që, të strukur borigave, si ujqër të tërbuar mprihnin dhëmbët e prerë dhe ëndërronin pushtetin e humbur, Kola me armë në dorë me forcat e Sigurimit në ndjekje të armiqëve ngushtonte rreth tyre darën e drejtësisë popullore.

Dhe në ato ditë, kur ai kthehej i lodhur dhe i këputur nga ndjekja, nëna e priste te vatra mbase me zemër të dredhur, por me sy ëndërrimtarë. Ardha e Kolës ja shtonte gëzimin, ja joshte ëndërrimet. Eh sa shumë ëndërronte nëna plakë! Për kë të mendonte më shumë? Nusja Mare ja kish mbushë shtëpinë, dhe ajo ishte e gëzuar se fëmijët e shumë në Shqipërinë e lirë nuk rriteshin më me fukarallëk si më parë.

Po një herë ajo nuk e kuptoi aq lehtë Kolën. Ai kish munguar disa ditë me radhë. Flitej se në këto anë do të bëhej një gjë e madhe, se do të kri-

johëj një liqen, se do të ngrihej një hidrocentral, se do t'i vihej fre lumit të Matit. Dhe megjithëse ëndërrat e saj ishin të guximshme, ato nuk kalonin dot matanë vendit të saj, Rrëshenit ato s'e konceptonin dot hidrocentralin. Ajo s'mund të kuptonte se si uji mund të bëhej burim drite.

Dhe ato ditë ajo e priti Kolën me ankth e padurim, më shumë për ta pyetur e për t'u sqaruar për këto gjëra të reja, që ca i besonin e ca të tjerë s'i besonin, se sa për të marrë vesh se si e kishte djalin. Kështu, kur i biri u dha te dera, ajo s'priti të zhvish-te opingat, të hiqte pushkën nga krahu, po e mbuloi sakaq me një varg pyetjesh:

- A po më thue, o Kolë, si i vihet fre lumit?
- E po edhe i vihet, o nanë. A të çudit ty kjo?
- Aq sa edhe kullat e kapidanit në flakë, o bir.
- E po merre si çudi, moj nanë. Ja njashtu do të bahet. Me çudina po na mëson njitash kjo Partia jonë.
- E po qysh asht ai liqeni, o bir? E si e mbledh rodi ujin në një bjeshkë! Unë s'po i jap anë kësaj gjaje, jo!

Kola po e vinte re me bisht të syrit kërshërinë dhe entuziazmin e nënës. Të kish qënë një ditë tjetër mbase do t'ja kënaqte të gjitha kureshtjet. Po atë ditë diçka e mundonte. Kishte një hall që e shqetësonte. Kur vetë ai ishte shqetësuar, si do ta priste e ëma, ajo që ishte lindur në këto bjeshkë, që ishte bijë e nuse e këtyre anëve?

Ai u afrua pranë zjarrit të thante çorapet e ia-gura, e, sikur të kërkonte ndihmë, thirri edhe të shoqen, Maren.

- Pa ulu edhe ti njiher, o Marë.
- Me mue ke punë? — u gjegj Mara.

— Besa me të dyja. Ose ma mirë me thanë të treve na takon me e pleqnue këtë punë e mandej me vendue të tre së bashku.

— Ç'asht ky kuvend, o Kolë? — tha sërish nëna, që gjithshka po e bënte përherë e më kureshtare.

— E si me thanë... Duet me ju pyetë se sikur me thanë Partia: Ti, o Kolë për do kohë, e kushedi për sa kohë, duhet me shkue në një vend shumë larg Rrëshenit, ku ke me kalue në rreziqe, ndoshta... ja njashtu, mund të japësh edhe jetën...», si kishe me thanë ti, nanë, me u përgjegjë? Po ti Mara? A do ta bajshit zemrën gur e a do të më urojshit udhën e mbarë?

Gratë u panë sy në sy, e një thikë u cëmboi të dyjave zemrën. Pastaj u panë sërish në sy, sikur të donin t'i vidhnin mendimin njëra-tjetrës. Cila do të qëndronte më e fortë a më e dhimbshme, nana apo nusja?

«Po pse nuk po flet nana?» mendonte Mara. «Ajo gjithmonë ka folë e para!» Por këtë radhë nëna shikonte nusen. «Po pse nuk flet Mara? — mendonte. — Ajo asht e re e si i bahet po të mbesi pa burrin në votër?»

— S'u kam kujtue kaq të ligshita, he burrneshal! He, pse nuk po flitni?

— Të... shkojsh, o bir, — tha nëna. E në të njëjtën kohë u hapën edhe buzët e Mares, e cila mezi pëshpëriti. Kola qeshi me zemër. «Nga këto trimnesha, — mendoi ai, — gjithshka mund të kërkosh.» Pastaj qeshi me të madhe.

— Jo, — tha ai, — Partia nuk kërkon ndonji gja të madhe prej meje. Kërkon një gja fare të lehtë për ne. Ja, a e dinë si më tha Bardhoku sot?

«Shiko, Kolë, — më tha, — me ndërtimin e hidrocentralit, katundit Ulzë i takon me u shpërngulë. Të gjithë katundarët do të zbresin në Laç e në Milot. Atje do të marrin tokë, atje do të çelen dyqane, do të ndërtojmë një katund model, do të mbjellim edhe kumbulla e mollë, edhe arra e fiq. Ti duhet të udhëheqësh këto punë jo të lehta. Njerëzit janë mësue me atë rryp toke dhe e kanë vështirë të ikin, prandaj për ty kemi mendue të shpërngulesh në atë katund e të bahesh shembull për të tjerët. Ashtu e do puna». Unë e ndigjova Bardhokun dhe nuk e di si më erdhi. M'u kujtue gardhi i shtëpisë, pemët në oborr, zjarmi në votër. M'u mjegulluen sytë. E tash si po thoni ju, si me i thanë.

Po gratë nuk ngurruan, aspak:

— Të shkojmë, — thanë, — atje ku thotë Partia. Fjala e Partisë asht rruga jonë.

Nëna, pra, u mësua me kësi të papriturash. Po këto të papritura ishin lajmëtare të së bukurës, të së nesërmes.

Një herë tjetër Kola u kthye më i pikëlluar se kurrë. Mbase atë ditë ai burrë, me sy të butë e zemër të çelniktë, derdhi lot. Unë nuk e pashë atë të derdhte lot edhe kur i preku ballin e ftohtë birit të vetëm pa jetë, edhe kur i fshiu nga flokët dheun e lagësht, edhe kur i tha: «Ti vdiqe, bir, por vdiqe me nder. Po atë ditë që ai mori vesh për masakrimin e Martë e Prenë Tarazhit, nuk e mundi dot ligëshinë.

— Se mund të digjshin dhe të shkatërrojshin, ma merrte mendja. Se mund të vritshin e të pritshin edhe këtë e kam ditë. Po se mund të shpojshin më thika dy gra të reja jol!... Jo, këtë nuk e kam ditë.

Kështu u foli gjindve të shtëpisë Kolë Kaçorë.

pa kapërcyer prakun e derës atë ditë. Ajo që si një vihamë.

— Po ç'asht kjo gjamë, o bir? — ofshani nëna.

Partizani i pamposhtur e informatori i guximshëm vuri duart në kokë.

— Të poshtërit, katilat! Ata kujtojnë se kështu do ta trembin popullin e Mirditës, se do ta pengojnë atë të lidhet me Partinë. Ata mendojnë kështu se do t'i ndalojnë gratë e vajzat mirditore të shkojnë në hekurudhë. Edhe sikur të gjashtë bijat e mia t'i kisha të rrituna, të tana do t'i kisha çue. Rrësheni ka me pasë vajza që të çojnë në jetë fjalën e Partisë, Mirdita ka me pasë.

Kaluan vite. Atdheu i shkatërruar ndërtonte vepra të reja. Hidrocentrali që do të ngrihej donte forca të reja të shumta. Rrësheni e çoi në jetë fjalën e Partisë. A ndin, o mizori, o mbrapshtia e jetës, o bajraktarë? Mirdita po çon gratë e çikat në hidrocentral. Botës suej i erdhi fundi. Drita e hidrocentraleve tona nuk e njeh perëndimin.

— Po unë kë me çue — pyeste atë ditë vehten Kolë Kaçorri. — Ja ti nanë, ti Marë, ju do të shkoni vullnetare në hidrocentral. Dhe u nisën nëna e nusja Marë. Pas asaj dite, Frroku i vogël, që po rritej bashkë me Shqipërinë e re, bashkë me republikën, u mësua të priste me gëzim jo vetëm babën, po edhe gjyshen e nënën. Kjo ishte një pritje e re në këto anë. Ky ishte një zakon i ri. E zakonet e reja nuk hyjnë ashtu lehtë. Ky zakon mund të bënte të derdhte lot edhe Frroku, ta linte jetim e buzëplasur, siç la gjindet e Tarazheve. Dhe për këtë heroizëm, Frroku e ndjente veten kreftar, e bash për këtë ai e priste

gjyshen e nënën nga hidrocentrali me gëzimin e madh të jetës.

Dhe u rrit Frroku nëpërmjet bisedash për aksione, rapallitjesh së botës së vjetër, që po merrte fund. U mësua Frroku të mos i trembej syri e të mos i ligështohet zemra. U mësua Frroku të shkelte mbi paragjykime e bestytini, u mësua Frroku t'i qëndronte ballë për ballë shtërngatës.

Një shtërngatë jo e vogël qe edhe ajo kur e motra, Prena, kapërceu kufitë e Rrëshenit dhe shkoi në Tiranë në Kombinatin e Tekstileve Stalin. Po një dallëndyshe e vetme nuk bie pranverën. E dallëndyshet si Prena ishin ende të pakta në Mirditë. Rruga e revolucionit nuk është aq e lehtë. E ky revolucion i takonte edhe pjesës më të shtypur, gruas shqiptare, gruas mirditore.

Po ndërsa Prena e pati më të lehtë, se ajo u gjend në një ambient revolucionar, Frroku që mbeti në Rrëshen nuk e pati aq lehtë. Ikja e Prenës në Tiranë u kish prishur qetësinë konservatorëve, besimtarëve e fanatikëve. Në këtë zjarr shtinin me sa mundte e si mundte benzinë reaksioni e mbeturinat e klerit.

Por martesë e Prenës me një musliman në Tiranë kaloi çdo parashikim të fanatikëve. Ata nuk lanë gjë pa thënë.

Frroku, djalë në shtatë motra, nuk e pati të lehtë t'i qëndronte kësaj breshërie thashethemesh. Vinin nga shumë anë. Ishte një presion, i hapët dhe i fshehtë, nga armiq që hidhnin gurin dhe fshihnin dorën dhe nga ata që e kuptonin këtë punë si çartje, si turp, si braktisje të normave të malësorit. Bëheshin këto biseda për motrën e tij edhe në klub, edhe në rrugë.

1382

58056

BIBLIOTEKA E SHKENCËVE  
GJYKËSIA



Frrokut i kujtohej një ditë. Ishte festa e Zonjës, një festë fetare që vazhdonte të kremtohej. Në she-shin e kishës ishin mbledhur malësorë, cuca e nuse veshur bukur, gjokset e të cilave vezullonin nga stolitë e shumta. Kleri ende kishte rrënjë në këto anë. Kish akoma fshatarë që njeriut me veladon, për bindje ose zakon, i shpinin ende misër e grurë, i paguanin kungatën e i kërkonin mendimin. Partia, duke qenë e sigurt në drejtësinë e vijës së saj, duke mos dashur të fyejë besimtarët, e dinte se shpejt do të shterrte ky lum, që shpinte ujë në çelë, sepse burimin e kish prerë nëntori i kuq, nëntori i madh. Rrëketë pa burim thahen shpejt.

Por Frrokut nuk ja kish ënda këtë festë. Kish ardhur këtu i vështronte këta njerëz e këto nuse të reja që këndonin e festonin të mbledhur grupe-grupe. Ai donte në gëzime të tjera të derdhej kjo energji, ky gëzim njerëzish të lirë, por jo të çliruar nga paragjykimet. Një grup ja shtonte më fort zemërimin. E në këtë grup ishte edhe prifti. Ata herë flisnin me të fortë e herë e ulnin zërin. Ngandonjëherë shikonin edhe nga Frroku. Në një grup tjetër rapsodi i këndonte heroizmit të Bardhok Bibës. Dhe Frroku u maq të shkonte te ky i fundit, por kërshëria e bëri të kalonte pranë të parit. U afrua. Disa prej tyre e ulën zërin e disa vazhduan si më parë të bisedonin ashtu, të krekosur e të nxehtë nga pija që kishin gëlltitur. Hë-hë dhe e hodhën fjalën te Prenë. Njëri madje arriti edhe të thoshë: «Ça ka me u shqetësue, këtu ka burra? Deti kalbësinat i hjedh, diamantet i mban mbrendë». Frroku e dëgjoj. Si guxonte ai maskara t'i shante në sy të motrën. Prenën, luftëtaren? Një çast ai e humbi arë-

syen. Gjaku i malësorit ngriti krye. «Bjeri, Frrok! A kështu turpnohen malësorët para gjindve?» «A kështu je burrë?! Ku qëndron burrënia jote? Thonë dhe motrat se kanë vëlla!» Ai ju afrue pranë. Sytë i nxirrnin xixa e grushtet i kish mbledhur fort. Bëri një hap përpara, edhe një tjetër. Ata u tërhoqën, zërrat u mекën. Frroku dëgjoi një zë, e një dorë që i shtërngoi krahun.

— Ça je tuj ba, o Frrok Kaçorri?

— Do t'i shqyej si bishat në mal.

— Ata që janë për t'u shqye nuk do t'i shpëtojnë në drejtësisë së popullit, e ata që janë të gënjem nuk i shpëton grushti, po fjala. Kush nuk ka arësye, përdor mjetin. Si, ti, bir i komunistit, po kërkon me shpartallue një paragjykim të ndytë, tue përdorë një zakon të egër? E pse, tue rrahë mbrohet nderi i sat motre, që asht ballnaltë e që gojët e ndyme nuk mund ta përlyejnë? Merre shtruet. Mblidhe mendjen.

E vështirë qe për djalin e ri ajo ndeshje e atë natë ai vetë e diti si e kaloi. Por atë natë ai kaliti një tjetër cilësi. Duke u ngritur mbi sedrën e fyer, mbi egërsinë dhe injorancën, ai bëri një hap përpara. Që të ecësh në rrugën e revolucionit duhet të ndjesh dhe mbje. Është kjo dhembje që kthehet pastaj në forcë. Frroku ishte mësuar tani të ecte nëpër këtë rrugë, sido që t'i paraqitej ajo.

## Minatori

Ne mësuam fundin heroik të Frrokut. Dhe ky fund heroik shpjegohet me krejt jetën e tij. Ai jetoi pak, por punoi shumë. Ai u bë mi-

nator, jo pse Kurbneshi është në Rrëshen. Ai u bë minator, se vetë dëshoi të punonte në një front të vështirë. Po të mos qe miniera, ai përsëri do të kishte zgjedhur një profesion të kësaj natyre. Ai donte të hynte në pjesën më të fortë, më të kalitur e më të çelniktë të klasës punëtore. Kish dëgjuar të thoshin se minatorët janë kocka e kockës së klasës punëtore. I pëlqente ta dëgjonte e ta përsërishte shpesh këtë fjalë. Thoshin se e kishte thënë një njeri i madh. Mbase ai nuk e mori vesh ndonjëherë kush qe ai që e kish thënë, por që e kish thënë shumë bukur, për këtë ai nuk kishte asnjë dyshim. Çka mund të kërkojë të mirë te njeriu, e gjen te minatori: vullnetin, zemërgjerësinë, ndjenjën e solidaritetit, luftën për të kaluar vështirësitë. Me këtë bindje erdhi ai një ditë në minierë. Poshtë shpatit që të fut në luginën e thellë, ku ka hapur krahët miniera, Frroku ja kishte ngulur sytë përpara malit të lartë të mbështjellë me kësulën e bardhë të mjegullës së dendur. Ky mal është i bukur. Edhe ajo kësulë e butë, si pambuk i shtirë, i shtonte bukurinë peizazhit, të stolitur me pisha të larta. Dhe sikur desh të kuvendonte me të kaluarën, ai ju përgjigj asaj: «Po, në Kurbnesh është zbuluar vërtet një thesar i madh». Në zemër të këtij mali ndodhet një thesar i vërtetë, minerali i bakrit. Për këtë thesar ka nevojë jo vetëm Mirdita, por tërë atdheu, socializmi. Të mundim të kaluarën e hidhur, të mos lemë asnjë gjurmë të varfërisë, të injorancës, të ngremë dhe të lartësojmë popullin tonë, të ndërtojmë socializmin, këto ishin ëndërrat dhe mendimet që kishin pushtuar punëtorin e ri, minatorin e ardhshëm, atë ditë që zbriste poshtë

shpatit, për në zyrat e drejtorisë së minierës, në një nga ditët e vitit 1961.

## Hapat e para

Prengë Kabali, shef i kuadrit, e pa këtë djalë të ri kur hyri ashtu i qetë e me një hap të sigurt në derë dhe zemra i gufoi nga gëzimi. Mbase nuk kishte të drejtë të gëzohej aq shpejt Prenga. Po shefave të kuadrit nuk u gënjehet shpejt syri. Pastaj Frroku që si ajo dita e mirë me qiell të pastër që në mëngjez. Prenga u kënaq edhe kur djaloshi shkurtazi i foli për punët që kish kryer, për ushtrinë që kish mbaruar dhe për dëshirën që kishte të punonte në minierë e në nëntokë, në ballë të galerisë.

— Kqyre, kqyre, — tha Prenga. — Për në ballë të galerisë asht pak si shpejt, mör djalë, po ti nise një herë si vagonist, si zjarmëtar e mandej merr pistoletën! — Këto i tha Prenga, shpejt e shpejt, duke dashur të provonte djalin se mos vuante paksa nga marnia e të dukurit. E ku ta dinte Prenga që i jati, Kola, kur e nisi djalin në rrugën e madhe të jetës, midis porosive më të rëndësishme i dha dhe këtë: Jij i thjeshtë, kurrë mos u lavdëro, kurrë mos u mbaj mbi të tjerët.

— Si të doni, shoku Prengë, — gjegji djali. — Unë nuk kam asnjë kundërshtim.

— Pa më thuej, more djalë, — tha serish Prenga, — a je marrë me punë shoqnore në ushtri? — Djali u step pak e pastaj u përgjegj:

— Kam qenë sekretar rinie.

— Po pse s'thue, more Frrok, ti qenke edhe ak-

tivist. Mirë bolla besa. — Dhe ai i shtërngoi dorën djalit, i ra shpatullave dhe i uroi punë të mbarë. — Njerëz si ti i duhen minierës.

Prenga e dinte që Frroku shumë shpejt do të kalonte te marteli. Dhe ashtu ndodhi. Duke kryer punën e vagonistit, të armatorit, të zjarretarit, Frroku mori kategorinë e pestë dhe e mbështeti në gjoks martelin. Marteli në gjoks ishte për veshët e Frrokut më shumë se një këngë. Ai hynte në minierë i pari dhe dilte i fundit. Nuk mbeti kurrë pa realizuar normën, detyrën.

Po erdhi një ditë e ai nuk u mjaftua vetëm me rezultatet e tij. Rrezen e shikimit e shtriu matak në frontit të vet, turnit e galerisë së vet. Ai u shqetësua së bashku me ndërmarrjen, me organizatën e Partisë dhe me organizatën profesionale për çdo problem. Detyrat e reja dhe ritmet e reja të planit të 5-të pesëvjeçar kërkonin edhe një organizim të ri në punë. Njëra nga çështjet ishte edhe vendosja e normave kolektive. Ishte fjala këtu për një sistem të ri pune, i cili ndeshëj me koncepte, kishte të bënte me kushte subjektive e objektive. Lufta për fitoren e normave kolektive në galeri ishte lufta për fitoren e ideologjisë proletare, ishte lufta për fitoren e vendosjes së interesit të përgjithshëm mbi atë personal, individual.

Dhe ky mendim nuk ju shqit Frrokut as ditë, as natë. Si ai mbasë mendonin dhe shumë të tjerë, po hapi i parë nuk ishte aq i lehtë. Ai vendosi ta bënte i pari këtë hap, duke dhënë shembullin personal e duke mos përfillur interesin e tij të ngushtë. Frroku nuk ishte nga ata të prapambeturit. Kisha zëra që spekullonin në këtë ide.

«E di si është puna, — thoshin ata. — Normat kolektive i duan më shumë dembelët. Ata fshihen më mirë kështu prapa shkëlqimit të të tjerëve. Jo, besa, të punoj unë e të hajë dembeli?»

Pikërisht kundër këtij mendimi deshi të luftonte Frroku. Ai ju përvesh një agjitacioni të gjerë. Kushedi sa herë me radhë ndenji në galeri pas 8-orëshit. Dëgjoji edhe thumba prej ndokujt:

— Ke ndërrue mjeshtërinë, o Frrok. Edhe kohëshënues, edhe numërues, edhe kontrollues do me u ba?

Po Frroku, që skuqej për hiç gjë, nuk u fye nga këto fjalë.

— Pa ulur njiherë, — i tha shokut. — Ti je miniator i mirë. Edhe unë nuk jam i keq. Po kështu si punojmë, ne mbetemi të mirë vetëm për veten tonë e ma pak për minierën. Ti rend mbas planit dhe e realizon. Por shpesh shkel pashaportën teknike të minierës, nuk siguron shfrytëzimin racional të galerisë, e le frontin pa armaturë, pa pastrue. Po deshe edhe e verifikojmë. Ja, shiko aty frontin ku punon Isufi, Deda.

— Kështu me biseda, si kjo, Frroku u bë jo vetëm përkrahës, por edhe zbatues i normave kolektive.

«Zakonisht në minierë, — tregon ish-drejtori i minierës Prengë Pepa, — është bërë një traditë si kjo: brigada merr më shumë emrin e brigadierit që drejton, se sa të galerisë ose të furnelit në të cilin punon. Kështu, ato marrin emra, bie fjala, si brigada e Prengës, e Markut etj. Ky është një sadisfaksion, që i jepet brigadierit, dhe brigadierët vetë mundohen ta justifikojnë këtë vlerësim. Po brigada ku punonte Frroku bënte një përjashtim. Frroku e kishte

merituar këtë nder pa qenë brigadier. Brigadieri ishte me të vërtetë një minator i zoti e një drejtues i mirë, po Frroku shkëlqente. Ai ishte edhe minator edhe organizator. Prandaj brigadierit nuk i vinte aspak keq kur dëgjonte nëpër mbledhje ose nëpër biseda të lira të thuhej «E tejkaloi planin brigada e Frrokut», ose «Në cilin furnel punon brigada e Frrokut?»

Një ditë drejtori i ndërmarrjes i tha Frrokut:  
— Mendojmë të të emërojmë brigadier. Duam të bëjmë shembull brigadën tuaj. Kështu, ti do të ndikosh më mirë në 30-40 punëtorët e brigadës.

Frroku e dëgjoi me vëmendje e me dashamirësi. Bile kënaqësia e ligjshme e bëri edhe të skuqej. Po pastaj u përgjegj shkurt:

Unë si komunist duhet të jap shembullin tim në frontin më të vështirë. Prodhimi ka më shumë nevojë për minatorë me martel në dorë. E sa për brigadën, mos u shqetëso. Do të përgjigjem për të edhe si punëtor edhe si brigadier.

## **I papajtueshëm me të metat**

«Ba me ardhë shpejt, — i pat thënë një mën-gjez Dava ashtu e përgjumur, — do të të çoj në staille me kqyrë çfarë vëshash të shëndoshë e të bukúr kemi. E di sa shumë i due! Si thue Frrok?.. Ça kam me lindë... Sikur me të ngja ty!» Këto fjalë të së shoqes mendonte Frroku ndërsa ngjiste lart monopatín për të dalë në xhade. Dita ishte e bukur, e pishat e larta, duke thithur ngrohtësinë e verës,

shpërndanin një pui të freskët. Kur erdhi pranë fabrikës së pasurimit, i tërhoqi vëmendjen një ku- vendim i zjarrtë, që zhvillohej nën hijen e një du- shku. I zuri veshi se flitej për vagona, për gurë e mi- neral, e kuptoi se po bisedohej për punët e nëntokës.

— Qe, besa, në kohë je dukë o Frrok Kaçorri, — i thirri njëri nga biseduesit — Kena ra në hile, e kjo ne na prish punë e ju korit ju. Si i bahet, bre burrë, me hedhë mineral në furrë e me nxjerrë gurë?

— Me kë e kini, o shokë, — ju përgjigj Frroku, që ndjeu se diçka e ftohtë i ngjethi krahët.

— Me ty e me brigadën tande jo, po me ata të Ortit 42. Nuk e kemi punën mirë me ata. Nuk e di- më kush e ban e si e ban, po disa herë me radhë i ta- kon fabrikës të përpunojë gurë. Venë gurë për fund e mineral përsipër si pa qeder pa mendue se kështu- damtojnë vendin, shokët e gjithë shoqinë.

Frroku u ul këmbëkryq midis tyre. Ai ishte krye- etar i komitetit profesional dhe nuk mund të rrinte indiferent. Kjo ishte një çështje serioze, që duhej zgjidhur, duhej ndërhyrë, duheshin zbuluar të pandërgjegjshmit. Hyri në bisedë dhe kërkoi të dinte se në ç'turp e në ç'kohë ishin konstatuar këto. Pas- taj u kthye menjëherë në minierë. S'ishte një punë aq e lehtë kjo. Fajtorët nuk e kanë të shkruar në ba- llë gabimin. Po Frroku më në fund i gjeti. Më e vë- shtira për të ishte që ata ta kuptonin gabimin. «Nuk asht puna me kritikue dy punëtorë, — mendonte Frroku, — asht puna me fitue mbi një koncept, me krijue një ambient mbytës për veprime kësi soji». Prandaj ai bëri mbledhjen e organizatës profesiona- le. Mbase kjo mbledhje nuk e zgjidhi krejt problemin, por minatorët e kritikuar pranuan haptaz gabimin.



Dhe nuk ndodh shpesh që i kritikuari ta shohë me sy të mirë atë që e kritikon. Dhe në e bëftë këtë për sy e faqe, në fund të shpirtit i ruan atij një farë inati. Po Frrokut nuk i ka ndodhur kurrë t'i mbajnë inat. Kritika e tij ishte parimore dhe dashamirëse. Kritika e tij ishte e shëndoshë, e ashpër dhe objektive.

### **Kur nxehet Frroku do të thotë se është kaluar kufiri. . .**

Unë mbaj lapsin në dorë. Dua të shënoj gjithshka që thonë shokët për Frrokun. Nuk e kam patur kurrë kaq lehtë të grumbulloj material. Nuk ka nevojë të kërkosh, të pyesësh. Shokët flasin vetë me qetësinë e sigurinë e minatorit, që i karakterizon.

Drejtori i minierës, Gjergj Kolë Marku, e ka vështirë të flasë. Jo se nuk di ç'të thotë, po se nuk di nga t'ja nisë.

— E di si ishte Frroku? — më tha ai pas një çasti hezitimi. Ishte si ai lumi plot ujë që s'di kurrë të shterrojë. Ishte i thellë e i qetë. Po një herë ama e pushë të nxehur. Dhe kjo ngjau 4 ditë para se të binte. Ishte ora 2.30, koha që shkëmbehen turnet. Ishte fjala për një mbledhje të shpejtë të organizatës profesionale të të dy turneve. Do të raportohej mbi gjendjen dhe mbi rezultatet e emulacionit. Dikush kishte thyer disiplinën dhe dy vagonistë qenë grindur. Biseda u ndez. Të kritikuarit mundoheshin të justifikoheshin. Ndërsa minator Deda i bënte dredha.

plumbit. Frroku priste që ai të kuptonte gabimin. Po ai nuk përmendej. Atëhere, si një grykë tarazhi kur shkarkon mineralin, u dëgjua zëri i Frrokut: Ty, Dedë, të mungon sedra e punëtorit. Të i mungosh pa arësye, në një kohë që prodhimi ka nevojë për ty, në një kohë që atdheu do bakër, në një kohë që jemi betuar të gjithë të vemi në Kongres me plan të realizuar? Çfarë i thonë kësaj? Ky është dezertim, o Dedë... — Minatori ngriu në vend. Kur nxehet Frroku do të thotë se është kaluar kufiri...

## Kur jep shembull Frroku

— E di ç'do të thotë të jesh minator me martel në dorë? — më tha tekniku Ibrahim Cara. — Bano rret e qytezës së Kurbneshit e çmojnë emrin e minatorit. Minatorë janë ata që i shkëpusin shkëmbit mineralin. Po ka minatorë e minatorë. Frroku ishte minator nga ata të vijës së parë, të frontit më të vështirë. Dhe si i tillë ai s'kërkoj kurrë më të lehtë, por më të vështirën. Më kujtohet, — vazhdoi tekniku, — kur ishte fjala për frontin — 60, që nuk realizonte planin. Duke nxjerrë si shkak-kushtet më të vështira, thellësinë më të madhe, atmosferën më të rëndë, mundësinë më të madhe për rreziqe, justifikoj kohëz mosrealizimi i planit. Detyrat e vitit dhe të pesëvjeçarit nuk bënë dallime për frontet. Duhej thyer koncepti se në këtë front nuk mund të plotësohej norma. Duhej gjetur për këtë një mbështetje

e fortë. Dhe pika e mbështetjes u bë Frroku. Ai shkoi në frontin më të vështirë; ku e realizonte planin 110 deri 130 për qind. Bile muajt e para paga ishte më e vogël. Por kjo nuk ishte kryesorja për të. Kryesorja ishte shtimi i prodhimit. E bëri këtë me punën e heshtur e zemrën e madhe. Me fjalën e zjarrtë e kujdesin e vazhdueshëm. Ishte zor të mos të të ngrohte entuziazmi i tij. Ai depërtonte thellë. Ishte forca e veprës dhe e fjalës bashkë.

Kështu frontet e zonës — 60 të thellësive të mëdha, dhe e kushteve të vështira, i rritën standartet. Ato do t'i mbajnë këto standarte, se në themelet e tyre është gjaku i Frrokut, se ndërgjegjija e tij mbeti në ndërgjegjen e minatorëve. Minatorë të fronteve — 60, mos e harroni Frrokun!

## Solidariteti punëtor

Njëqind e mbase njëmijë herë është kthyer me mend Dodë Tusha, zëvendëssekretari i Partisë, tek ai çast kur e luti Frrokun të linte furnelin e të plotësonte fletanketën. «Si, xhanëm, nuk e detyrova, pse nuk e urdhërova?» qorton veten ai. Oh, pse lajthitësh kështu, o Dodë Tusha? Si e harrove kaq shpejt karakterin e shokut? Si, a kaq shpejt kthente Frroku? Kaq shpejt e linte punën në mes ai? Ti, o Dodë Tusha, nuk e urdhërove dot edhe një herë tjetër, kur jeta juaj ishte në rrezik, kur vendosnin minutat! Doda me sytë e mendjes kujton vazhdimisht atë ditë. Aksidenti u ndodhi tre shokëve të minierës:

Frrokut, Dodës dhe Nikollës. Në kohën që Doda ndezi minat, një cep i galerisë me armaturë e shkëmb i zuri krahun. Pesha ishte e madhe dhe rruga e shblokimit shumë e vështirë. Doda u mundua dhe u ngjeth. Fitalat ishin ndezur. Qe punë 3-5 minutash. Duhej zgjedhur: ose t'i pritej krahun, ose të humbte jetën. Me një zë të dredhur ai dha vendimin:

— Nikollë, Frrok, më prisni krahun, qe ku asht sopata. Due të jetoj. Më prisni krahun!

Heshtje. Asnjë përgjigje.

— Atëhere, shokë, ikni, ikni sa më shpejt. Minat janë gati. Nxitohuni.

Po kush mund të lejë shokun në rrezik?! Punëtorët, luftëtarët, komunistët nuk i kanë lënë armikut kufomën e shokut dhe jo të lënë shokun gjallë në atë rrezik. Kujt i bënë këmbët të ikte? Cila zemër mizore mund ta lejojë këtë?

— Ikni, shokë, shpëtoni, më pritni krahun!

Po shokët, me një shpejtësi të rrufeshme, duke mbledhur të gjitha forcat, guximin, gjakftohtësinë, me qysqi e sopata i liruan krahun shokut. Minat plasën kur ata qenë jashtë çdo rreziku.

## **Ai nuk e njihnte gjuhën e justifikimit**

Te lapidari i Marte e Prena Tarazhit qëndrojnë shpesh minatorët. Presin ndonjë maqinë. Ngandonjëherë ato nuk i marrin. Ka minatorë që shqetësohen seriozisht për vonesën. Ka edhe të tjerë që justifikohen. «Epo, na la maqina! Ç'të bëjmë ne?» «Kë-

të justifikim, thotë shefi i kuadrit, Prengë Kabali, nuk e dëgjova kurrë nga goja e Frrokut. Më kishte ndodhur disa herë ta ndeshja me 2 orë natë, atje të mbështetur te lapidari, sidomos kohët e para pas martesës».

— Po pse je çue kaq herët, o Frrok? A lihet kë-shtu nusja e re? — Ai qeshte. Unë nuk arrija t'i shihja sytë, por ndjeja ngrohtësinë dhe ëmbëlsinë e zërit që më thoshte.

— Jo, mor Prengë, nuk ban. E di që shokët ma falin vonesën, por unë nuk ja fal vetes.

## **Nuk i falet atij që kritikohet për së dyti**

Në vitin 1970-71 ai kreu shkollën njëvjeçare të BPSH në Durrës. Vuri të gjitha forcat që të dilte mirë. I mësuar me martel në dorë, nuk e pati edhe aq lehtë. Një herë atë e kritikuan në mbledhje. Tërë atë natë u përpoq si peshku në zall.

Shoku i tij i dhomës, Marku, u habit kur të nesërmen në mëngjez nuk e pa në shtrat. E gjeti më vonë bregut të detit me një libër në dorë.

— E ke marrë me vrull, o Frrok.

— Nji herë kritikohen minatorët. Nuk i falet atij që kritikohet për së dyti, — ja ktheu ai.

Dhe atje, në atë shtëpinë e thjeshtë me dy të ndara, është varur në mur një fotografi. Janë shokët e shkollës që i kanë dhënë fjalën njëri-tjetrit të takohen në vitin 1975. E shoh atë fotografi. Shoh në mure edhe një bibliotekë. Bashkë me librat e kursit dhe materialet e Partisë, janë rreshtuar edhe disa

dispenca. Janë librat e teknikumit. Ai ndiqte edhe shkollën.

Ai s'arriti dot të përcillte fëmijtë e tij në shkollë t'u blente abetaren, t'u gëzohej për notën e parë. Po ajo fotografi dhe ato libra do t'u flasin fëmijëve se si babi minator, bashkë me martelin, mbante edhe librin.

## Aktivisti

Pjetri e ndoqi me sy Frrokun deri sa ky humbi në kthesë. Takimi me këtë njeri i linte gjithnjë një përshtypje të veçantë. E pra Frroku nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme. Dhe Pjetri përsërit me mendje bisedën që u zhvillua atë ditë.

— A nuk do të shkojsh në shtëpi, Frrok?

— Jo!

— Po tash ora asht 13. Ti don ma shumë se 1 orë të mbërrish në minierë. Në orën 15 ju lini punën, nuk ke çka ban tash në minierë. Shko nesër nadje.

Ai me habi u gjegj:

— Me thanë të drejtën, o Pjetër, mue më vjen zor edhe kur marr leje me ardhë në mbledhje. Asht detyrë shoqnore. Diçka më therr në zemër kur largohem nga puna bash njetë orë që mund të siguroj disa vagona mineral. Pjetri, sekretar i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit të Rrëshenit, e njeh mirë këtë aktivist të palodhur. Janë të rralla kandidaturat si ato të Frrokut që në zgjedhjet e organizatës profesionale thuajse nuk diskutohen fare.

Të zgjidhesh kryetar i komitetit profesional në minierë nuk është gjë e lehtë.

Komunistët e minierës e mbajnë mend mirë se si u zhvillua mbledhja për pranimin e Frrok Kacorit në Parti. Në atë mbledhje të organizatës bazë, që u zhvillua në një nga ditët e janarit të vitit 1971, kish shumë komunistë të vjetër, minatorë të zotë e drejtues me përvojë. Sekretari i Partisë kaloi në shqyrtimin e dokumentave që kishte në dorë për pranimin e Frrokut nga kandidat në anëtar Partie. Ai e tha fjalën e tij dhe kërkoi pastaj mendimin e komunistëve.

Një heshtje paksa e gjatë. E pastaj një aprovim i njëzëshëm. «Nuk kemi asnjë vërejtje. Ai është një shembëll për të mësuar të tjerët». Është vështirë të thonë kështu komunistët e vjetër, minatorët e vërtetë. Po Frroku, megjithëse i ri, kishte dhënë shumë prova. Njerëz me kurajo i duhen Partisë. Frrokut nuk i mungonte kjo. Ja ç'tregon Gjergji, drejtori i minierës. Në minierë bëhen shumë mbledhje. Ca mbase edhe duhen lënë. Duhet bërë pak e sak. Për këtë ishte dhe Frroku. Por kur vendoset, ajo duhet të bëhet. Frroku ishte i rreptë për korrektesë, i rreptë ndaj mungesës së përgjegjësisë. Një ditë drejtorja e ndërmarrjes organizoi një mbledhje të rëndësishme me kuadrot tekniko-inxhinierë dhe të organizatave shoqërore. Në mbledhje mungonin disa anëtarë të komitetit profesional. Mungesa u vu re. Dikush edhe i kritikoi. Një tjetër tha se ata shokë nuk bënë mirë që nuk erdhën në mbledhje. Ata ishin edhe anëtarë të komitetit profesional, edhe me detyra të rëndësishme, shtetërore. Frrokut, që priste të merrej më seriozisht kjo çështje, nuk i pëlqeu që

u kalua lehtas. Ai diskutoi me sekretarin e Partisë. Pastaj, në një mbledhje të komitetit profesional, i thirri shokët që munguan. Çështja u diskutua drejt dhe prej diskutimit u përfitua. Kur u pyet pse e bëri të madhe, Frroku u përgjegy:

— Ç'kuptoni me fjalën «të madhe»? Në s'bamë tjetër veçse u kërkuam llogari shokëve tanë për neglijencë. Nuk asht fjala këtu për të dënuar, po për të mos u hapur rrugë gjanave të papëlqyeme. Po u kujdese për të voglën, ke fitue të madhen.

Si do që të bëjë dimri në Shqipëri, në Kurbnesh është i fortë. Kurbneshi është një luginë që mbledh shumë erëra e ku bie shumë dëborë. Minierën minatorët nuk e kuptojnë dot pa dëborë. Janë mësuar me të. Po vitin që kaloi Frroku shfryu një herë keqas kundër dëborës. Ishte mëngjez. Një mëngjez i ftohtë me dëborë të bardhë. Ajo ishte e bardhë edhe atje në grykën e galerisë, edhe te gryka e tranazheve. Kjo bardhësi të vriste sytë. Maqinat nuk kishin mundur të prishnin këtë bardhësi të rrugës. Peisazhi i bardhë dhe moti i ftohtë i pëlqyen Frrokut vetëm për një çast. Pastaj ai vuri re më me kujdes rrugën dhe pa që andej nuk kish shkuar njeri. Vuri veshin të dëgjonte ndonjë uturimë maqine, po lugina binte vetëm sokëllimën e një ere të ftohtë. Edhe në grykat e galerisë mbretëronte qetësia. Ora po kalonte dhe minatorët nuk po dukeshin. Frroku nuk kuptonte se çfarë po ndodhte në qytet, por për një gjë ishte i sigurtë. Dëbora e madhe kishte penguar komunikacionin. Maqina nuk i binte dot punëtorët. Rrugë të dytë, qoftë edhe këmbësore, nuk kishte.

Nuk dimë se në çfarë ore e filluan punën minatorët atë ditë. Po dimë sak se ajo ditë, ai incident, u



bë shkas për një mbledhje luftarake e për një aksion konkret të organizatës profesionale të zonës. Frroku, kryetari i komitetit, e shtroi problemin me anëtarët. Ai tha:

— Qyteti asht larg minierës një orë. Ne vijmë në punë me maqinë. Dhe kështu do të vijmë. Po kur bie shumë dëborë e nuk çan maqina? Ahere duhet me ç njerëzit, duhet me gjet rrugë njerëzit. Atdheu do krom dhe kromi nuk do me dit në ka ose nuk ka rrujë. Unë kam mendue një plan për këtë. Me hap rreth malit një rrugë që lidh minierën dhe qytetin nga ana e lumit, due me than nga ana e kundërt e rrugës automobilistike. Disa kilometra rrugë shtegtarësh nuk do të na kushtojë shumë. Një aksion me goditje të përqëndrueme dhe puna merr fund. Si thoni ju?

E kush mund të thotë të kundërtën kur vetë kryetari prin përpara?

## Si e dashuroi Dava Frrokun

6 shkurti i vitit 1967, që hyri në historinë e luftës për emancipimin e mëtejshëm të gruas shqiptare si një erë e re, e gjeti Frrok Kaçorrin të fejuar. Nuk ish fejuar që në djep dhe nuk ish fejuar me detyrim. Por, ama, nuk ishte fejuar as edhe ashtu si thotë Partia, me njohje të thellë, me dashuri. E kish parë ca herë, aq sa t'i ndizeshin ëndërrat. Fytyra e saj i dukej shumë e dashur, e afërt, e ngrohtë. Tashti ai e kish krijuar në përfytyrimet e veta atë që do të bëhej së shpejti gruaja e tij. Po kjo ishte vetëm një

anë. Ky ishte vetëm mendimi i tij. «Po ajo, Dava? Unë e dua, Po Dava a më do? A i shtërngohet edhe asaj zemra në gjoks si mua, kur më kujton? A e di ajo si jam unë?»



Dava, e shoqja e Frrok Kaçorrit, duke folur në mbledhje kur ju dha Frrokut titulli Hero i Punës Socialiste.

Me këto mendime në kokë Frroku jetoi disa ditë derisa i dha karar kësaj pune. «Të thonë ç'të duan të tjerët. Le të më tallin po deshën. Unë do të vete te fshati i Davës, unë do të kërkoj ta shoh, të më shohë, të flasim e të qeshim bashkë», vendosi më në fund Frroku.

Ta bënte këtë hap. donte edhe shokë. Ca e për-

krahën, ca heshtën. Por Frroku, sa linte minierën, mernte rrugën e fshatit të Davës. Herë e gjente në arë duke prashitur e herë duke mbushur ujë. Po si një sorkadhe që i trembet gjahtarit, ajo zhdukej. sa të hapte e të mbyllte sytë Frroku.

Por tamam kur Frroku ish ligështuar pak e priste, ndodhi ajo që Frroku e kujtonte shpesh me mall, me një ndjenjë kënaqësie të thellë. Ishte për të ai një kujtim i dhemshur, i bukur, i ngrohtë.

Rinia e Mirditës do të dërgonte në hekurudhën Rrogozhinë-Fier brigadat e saj. Një aksion ky që ngriti më këmbë të gjithë. Kish mbetur prapa koha e Prenës, e të motrës, por përsëri nuk ishte aq lehtë. Ca prindër i shoqëruan vajzat deri në hekurudhë. Frrokut i lindi një mendim i mirë. Në hekurudhë të vente edhe Dava. Me një grup shokësh shkoi në fshatin e Davës. U rregjistruan për në aksion shumë të reja. Po Dava? Frroku fluturoi nga gëzimi, kur mori vesh edhe për të. Ai e priti ditën e nisjes me një gëzim të heshtur e të plotë. Ky gëzim e kishte push-tuar krejtësisht. Dava shkonte në aksion, Dava shkonte në dasmën e saj. A nuk ishte kjo dasma më e bukur? Po a mendonte, vallë, kështu Dava?

Dhe dita erdhi. Rrësheni zjente atë ditë nga këngët e aksionistëve. Po të gjitha vajzat nuk këndonin. Shumica rrinin të ndrojtura. Thua jse të kapura njëra pas tjetrës si ata fëmijët e kopshteve që mbahen pas bluzave të shokëve, mundoheshin të kuptonin ndryshimet që po ndodhnin. Brigada u rreshtua. Vajzat nuk e mbanin rreshtin. Asaj që i binte të ndahej nga shoqja e fshatit, ngutej t'i afrohej sërisht. Ishte kohë e mirë. Qielli qeshte, po më shumë qeshnin sytë e Frrokut. Ai e ndiqte me sy Davën,

po vajza, që nuk ja njihite as fytyrën, nuk dinte kua ta kërkonte. Sytë paksa të hutuar i kalonte sa në një grup të një tjetër, po pa ditur ku t'i ndalte. Një shok nga të komitetit të rinisë, si bëri apelin e dhadisa udhëzime njoftoi brigadën se kë do të kishin sekretar:

— Sa kohë që do të rrini në hekurudhë, do të kini sekretar rinie shokun Frrok Kaçorri. Ai do të interesohet për ju. Për çdo çështje që të kini drejtohuni atij. Kur Frroku bëri përpara, Dava i ngriti sytë me guxim. Shoqet po e shtynin me bërryl. Dikush i pëshpëriti në vesh. Po pa mundur të kapte me hollësi tiparet, fytyrën, ajo deshi të mbante mend ngjyrën e xhaketës. «Do ta ndjek me sy — tha Dava. — Në mos mbërrifsha me ja pa mirë fytyrën, kam me i pa shpatullat, flokët, kryet». Por pas-taj brigada u shpërnda në maqina dhe ata i humbën sysh njëri-tjetrit. Dava nuk arriti dot ta ndiqte, e Frroku, që interesohej për gjithë brigadën, e la votëm Davën me ëndërrat e saj.

Por në mbrëmje, kur në qytezën e vullnetarëve u shtrua darka e parë, Frroku mori guximin dhe u ul të tryeza e Davës. Ajo puliti sytë dhe u hoq anash. Mblodhi edhe këmbët. Dëgjonte si të ishte në ëndërr zërin e Frrokut. «He, si thoni, vajza, a të ulem këtu?» Po ajo nuk kish fuqi të përgjigjej. Zëri i mbeti në grykë, gjunjët ju prenë. Të mos kish qenë ulur, me siguri do të kish rënë. A thua këto ishin shenjizat e para të dashurisë? Ajo dëgjoi prapë si nëpër ëndërr vajzat që me gjysmë zëri i thanë. «Populu, Frrok». E me vete tha «Sa mirë». Frroku e ndjeu këtë dhe një gëzim i madh i vërtetë e pushtoi të tårin.


## Pushka nuk mbeti në armaturë

16 shtator, ora 16. Ishte një ditë e ftohtë me llohtë. Lugina ja përcillte llohtën minierës me të sokëllitura. Minatorët e rreshtuar në stërviçje nuk duan t'ja dinë. Nuk do t'ja dijë as Kolë Kaçorri, i jati i Frrokut, që vetëm 4 orë më parë i dha lamtumirën e fundit të birit. Ai e mban kokën lart dhe veshët mprehë. Ka frikë se mos ulërима e luginës e helmi i dhimbjes i pengojnë dëgjimin. Pranë i rrinë shokët, bashkëluftëtarët. Pranë i rrinë minatorët. Ai do të dëgjojë ç'thonë për Frrokun e tij, për birin e tij të vetëm në mes shtatë vajzave, për gëzimin e tij. E pse, o Frrok, nuk e le babën partizan, veteranin komunist ta gëzonte të plotë ate nder të madh, të të përcillte në Tiranë, të të jepte përshëndetjet e mirëditorit për Enver Hoxhën?

Po ti nxitoheshe Frrok për në minierë. Dhe as lajmin që të zgjodhën delegat nuk ja dhe vetë. Ja thanë shokët, «Të mirë e të urtë, punëtuer e të dashun e kam ditë se e kam pasë, po sa me e meritue këtë nder të madh... Të rrojë Partia që i dha një emën, që i dha kaq nder». Kështu u tha ai shokëve.

Kështu tha ai kur e uruan shokët, kur i gufontë zemra nga gëzimi.

«Vdiqe si burrat, bir, më nderove. Kam vetëm një pishmanllëk. Se jam i vjetër e si minator nuk mundem me të zvendësue. Tjetër kund kam me qenë ku ishe ti. Ti nuk ke vdekun po ke le. Socializmi asht luftë. E pse mue më ra një pjesë ma e madhe e kësaj lufte, kjo ma zbut dhimbjen e ma shton nderin». Kështu tha ai kur i preku flokët e butë dhe e puthi në ballin e ftohtë.



Kolë Kaçorri, që zëvendësoi të birin në kongresin e Partisë.

«Frroku juej dhe i jemi nuk rron ma. Ai ra në krye të detyrës, në frontin ma të vështirë, në luftë për t'i dhanë sa ma shumë bakër atdheut. Dëshira e vetme dhe ma e madhja e tij ishte me shkue në kongres me plan të realizuem. Partizanët, mbasi u vritej një shok, vritshin ma shumë anmiq. Edhe ju plotësoni dëshirën e tij. Mbani amanetin e Frrokut. Ky asht nderi ma i madh për të». Kështu tha ai kur arkivoli preku dhenë.

Dhe ja tani ky burrë i fortë si shkëmbinjtë tanë, që dhimbjen e ka kthyer në forcë, është rreshtuar në repart. Bie shi. Bie llohë dëbore. Reparti i tërë gati. Dëgjohet zëri i komisarit. Paraqitet forca. Efektivitë është gadi për veprim. Mungon komandanti i kompanisë së parë, oficer Frrok Kaçorri, që ra në krye të detyrës.

— Jo, nuk mungon. Unë jam këtu, — përgjigjet një zë.

Është Kolë Kaçorri, që ka ardhur të zërë vëndin e të birit.

Arma nuk mbeti në armaturë.

«Djali em dhe shoku juej ra në krye të detyrës. Ju jeni mbledhun për një stërvitje të madhe. Ndonëse kam disa orë që e kam varrosun Frrokun, erdha këtu me i zanë vëndin unë, baba i tij, që Partia më ka edukue në gjinin e saj, do të jem pjesëtar i efektivit tuej. Do ta mbaj me nder armën e Frrokut, siç e mbante ai. Deri në vdekje do të luftoj kundër anmiqve imperialistë e revizionistë edhe për vete edhe për djalin tem. Kryeni sa ma mirë detyrën, kunorëzoni atë me sukses. Kjo ishte dëshira e Frrokut».

Kola nuk ka më fuqi të flasë. Rezervistët ulin kokën. Ndonjë lot u shpëton fshehtas qepallave.

Aj i sheh me sy qortues. «Trimat, punëtorët, as qahen, as qajnë». Kështu tha ai, komunisti që dhimjen e ktheu në forcë.

## P a s t h ë n j e

Dhe erdhi nëntori ynë i madh, nëntori i jubileut të kuq, nëntori i festave të vitit 1971. Dita e tij e parë ishte një nga ditët më të bukura dhe më të shënuara për të gjithë. Kongresi i Partisë priti nga të katër anët e vëndit delegatët e tij.

Nga të gjitha rrugët, që nga bjeshkët e bardha e deri tek fushat e buta dhe të ngrohta, u derdhën në

Tiranë bijat dhe bijtë më të mirë të Partisë. Në fytyrat e tyre ndriste gëzimi dhe në gjokset e tyre buciste kënga për fitoret që mbartnin me vete. Gëzimin dhe harenë nuk e mbante dheu. Ata hynin në sallë njëri pas tjetrit me gëzimin në sy, me besimin në zemër. Po njëri mungonte. Njëri nuk arriti të ngjiste ato shkallë. Cili ishte ai? Cili ishte ai që nuk kishte ardhur në atë ditë të madhe, në atë ditë të bardhë?

Ishte Frrok Kolë Kaçorri, një nga delegatët më të ri në kongres. Po ai nuk mungonte. Kush tha se mungonte? Mund të vdesë ai që më lart e ngriti emrin e komunistit? Mund të vdesë ai që më lart e ngriti emrin e minatorit? Mund të vdesë pavdekësia, kur aio u përcillet gjeneratave që vijnë? A kanë vdekur Koci Bako, Qemal Stafa, Adem Reka, Muhamet Shehu? Shihni si ndritin viet e tyre në rrugën tonë. Një yll tjetër, një dritë tjetër është edhe Frroku!



## PERMBAJTJA

	Faqe
Në vend të parathënjes .....	5
Një lindje e bardhë, një vdekje e ndritur .....	6
Gjethi i njomë nuk mbin në degë të thatë .....	10
Minatori .....	19
Hapat e para .....	21
I papajtushëm me të metat .....	24
Kur nxehet Frroku do të thotë se është kaluar kufiri ..	26
Kur jep shembull Frroku .....	27
Solidariteti punëtor .....	28
Ai nuk e njihnte gjuhën e justifikimit .....	29
Nuk i falet atij që kritikohet për së dyti .....	30
Aktivisti .....	31
Si e dashuroi Dava, Frrokun .....	34
Pushka nuk mbeti në armaturë .....	38
Pasthënje .....	40